



EDUKIMI MJEDISOR



Tetor 2023

Edukimi mjedisor natyror i ndihmon nxënësit të njihen me çështje të rëndësishme dhe jetike mjedisore si: ujin, ajrin, tokën, natyrën, biodiversitetin. Edukimi mjedisor është veprimtaria akademike dhe praktike, që përfshin studimin sistematik të mjedisit dhe gjithë marrëdhënieve që e shoqërojnë; përmes vëzhgimeve dhe eksperimenteve. Përgjatë veprimtarive, nxënësit përfshihen emocionalisht dhe fizikisht; ata mësojnë për zgjidhjen e shqetësimeve dhe problematikave të ndotjes, mbetjeve, energjisë, ekonomisë qarkulluese etj., si dhe për mbrojtjen e dashurinë për natyrën.

“Shihni në brendësi të natyrës, më pas do të kuptoni gjithçka më mirë”

Albert Ajnshtajn (Albert Einstein)

Mentorët e tyre, të cilët janë specialistët e edukimit mjedisor në 12 AdZM-të e vendit mbështesin, përfshijnë dhe ndërmarrin nisma të përbashkëta me nxënësit për përmirësimin e mjedisve të ndryshme. Në sajë të këtyre veprimtarive ata zhvillojnë shprehi dhe dije mjedisore, që i bëjnë të veprojnë në mënyrë të përgjegjshme. Përmes edukimit mjedisor nxënësit e niveleve të ndryshme akademike përfitojnë:

vetëdije dhe ndërgjegjësim për mjedisin dhe sfidat mjedisore

kuptojnë dhe analizojnë probleme dhe çështje shqetësuese mjedisore

motivohen dhe përfshihen për përmirësimin e cilësisë së mjedisit në nivel lokal dhe kombëtar

ndërmarrin nisma dhe veprimtari që synojnë mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit



Përmes kësaj përmbledhjeje mujore Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura paraqet aktivitetet e zhvilluara nga 12 Administratat Rajonale të Zonave të Mbrojtura, përgjatë muajit tetor 2023, me nxënësit e shkollave të ndryshme në mbarë vendin dhe shkollave që ndodhen pranë ZM-ve, në zonat rurale. Aktivitete janë zhvilluar në kuadër të ditëve mjedisore, promovimit të zonave të mbrojtura, lojërave të ndryshme edukative dhe argëtuese në mjediset e shkollave apo në natyrë, duke synuar gjithëpërfshirjen e nxënësve të të dy gjinive, niveleve të ndryshme ekonomike dhe vendndodhjen gjeografike.

Nxënës të
përfshirë **800**

22 Specialistë të
angazhuar

“Edukimi mjedisor” nga AdZM Shkodër

ndryshime të klimës promovimi i turizmit fatkeqësitë natyrore ekoturizmi turizmi malor rreziqet dhe shkaqet natyrore peizazh malor veprime për klimën

13 tetor, Dita Ndërkombëtare për Zvogëlimin e Rreziqeve nga Fatkeqësitë Natyrore

Në kuadër të kësaj dite realizuam një orë mjedisore në shkollën 9-vjeçare “Ded Gjo Luli”. Nxënësit u njohën me rreziqet dhe fatkeqësitë natyrore, pasojat e tyre, rastet që kanë ndodhur, etj. Po ashtu, së bashku, biseduam se si mund të parandalojmë, zbusim shkaqet natyrore dhe si të jemi në gatishmëri ndaj tyre.



15 tetor, Dita Ndërkombëtare e Ecjes në Natyrë

Qëllimi i kësaj dite është ndërgjegjësimi mbi rëndësinë që ka natyra dhe mjedisi, si dhe promovimi i vendeve turistike, në funksion të zhvillimit të turizmit malor. Në kuadër të kësaj dite, së bashku me Well Point, Natyralistët dhe gjimnazistë të shkollës “28 Nëntori” Shkodër realizuam shtegun Ura e Bunës - Mali i Taraboshit, si një ndër shtigjet më të arritshëm për të gjitha moshat. Gjatë ecjes në shteg na shoqëroi një peizazh i mrekullueshem dhe i larmishëm malor, mes pyjeve me pishë të egër, shkurreve dhe kullotave. Përmes pikave panoramike të këtij shtegu mund të shihen pamje fantastike të Kalasë së Shkodrës, Liqenit të Shkodrës dhe Lumit Buna.

Nxënës francezë vizitojnë “Alpet e Shqipërisë”

Për disa ditë me radhë, një grup me nxënës, të Shkollës Pyjore “BTSA Gestion Forestière-ISETA” nga Franca, vizituan Parkun Kombëtar “Alpet e Shqipërisë”. Grupi i shoqëruar nga punonjësit tanë, përgjatë vizitës u njoh me zonën e Kelmendit, Vermoshit, Thethit. Vizitorët shijuan peizazhet e mrekullueshme të parkut dhe mësuan rreth pasurisë së florës, faunës, pyjeve e livadheve.

24 tetor, Dita Ndërkombëtare e Veprimeve për Klimën

Një ndër faktorët që ndikon në zbutjen e ndryshimeve klimatike janë edhe pyjet. Në datën 24 tetor, në bashkëpunim me Shkollën e Mesme të Bashkuar “Ded Gjon Luli” zhvilluam një aktivitet sensibilizues pyllëzimi. Së bashku me nxënësit mbollëm 50 fidanë të llojeve pishë e butë (Pinus pinea) dhe pishë e egër (Pinus silvestris) në oborrin e shkollës. Mbjellja e fidanëve dhe pemëve në mjediset e shkollave, shërben për rritjen e sipërfaqeve të gjelbëra, zbutjen e zhurmave dhe përthithjen e grimcave të pluhurit.

“Edukimi mjedisor” nga AdZM Kukës

monumente natyre ndotje vlera natyrore nisma të gjelbëra habitat zona të mbrojtura

3 tetor, Dita Botërore e Kafshëve

Në kuadër të kësaj dite, specialistët e AdZM Kukës zhvilluan një orë mjedisore në shkollën e mesme “Shishtavec”. Përmes prezantimit nxënësit u njohën me konceptin e habitatit dhe me disa prej llojeve që strehon Parku Natyror “Korab-Koritnik”.

9 tetor, flora dhe fauna në Parkun Kombëtar “Alpet e Shqipërisë”

AdZM Kukës në bashkëpunim me shkollën 9-vjeçare “Drogobi” kanë zhvilluar një orë mjedisore me temë “Flora dhe fauna në PK Alpet e Shqipërisë”.



9-10 tetor, nxënësit francezë vizitojnë Alpet e Shqipërisë

Disa nxënës francezë nga shkolla Pyjore “BTSA Gestion Forestière - ISETA” vizituan Parkun Kombëtar “Alpet e Shqipërisë”. Të shoqëruar nga punonjësit tanë, vizitorët eksploruan zonën e Valbonës dhe shtegun turistik “Dragobi-Valbonë”. Përgjatë shtegëtimi mysafirët u njohën me florën, faunën, veçantinë e pyjeve dhe peizazhet e mrekullueshme të Parkut.

11 tetor, “Vlerat natyrore dhe monumentet e natyrës në PK “Korab-Koritnik”

Specialistët e AdZM Kukës organizuan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Shkinak”. Përgjatë saj nxënësit u njohën me vlerat natyrore, monumentet e natyrës si dhe me disa këshilla për ruajtjen e faunës së egër.

20 tetor, “Ndotja dhe ndikimi i saj në mjedis”

Stafi i AdZM Kukës zhvilloi një orë mjedisore në shkollën 9-vjeçare “Orgjost”. Së bashku me nxënësit diskutuam rreth ndotjes, shkaqet kryesore dhe masat që mund të marrë çdo qytetar për zvogëlimin e saj, përmes angazhimit, kontributit individual dhe nismave të gjelbëra.

24 tetor, Dita Ndërkombëtare e Veprimeve për Klimën

Specialistët e AdZM Kukës zhvilluan një orë mjedisore me nxënës të klasës së 11-të në gjimnazin e Zapodit. Tema e përzgjedhur ishte promovimi dhe ruajtja e vlerave natyrore të zonave të mbrojtura të Qarkut Kukës.

31 tetor, “Promovimi i monumenteve të natyrës”

Stafi i AdZM Kukës zhvilloi një orë mjedisore në natyrë, me nxënës të shkollës 9-vjeçare “Novosej”. Për nxënësit ofruam të gjithë informacionin e nevojshëm rreth promovimit dhe ruajtjes së vlerave të monumenteve të natyrës, në brendësi të Parkut Natyror “Korab-Koritnik”. Përgjatë aktivitetit të zhvilluar me nxënës të klasave të ndryshme, specialistët e AdZM Kukës kanë shpërndarë fletëpalosje të përgatitura nga AdZM Kukës dhe AKZM.

**botanistë
shqetësim i kafshëve
ekosistem** sjellje në natyrë
rrëqebulli i Ballkanit
herbarium

2 tetor, Dita Ndërkombëtare e Ekosistemeve

Së bashku me nxënësit e Shkollës 9-vjeçare “Adriatik” zhvilluam një orë mjedisore në lidhje me njohjen e konceptit “çfarë është një ekosistem”. Më më pas të gjithë së bashku krijuam një ekosistem artificial në mjediset e klasës. Materiali i përdorur ishte: dhe i butë, shishe plastike dhe bimë të vogla. Në fund të orës mjedisore nxënësit vizatuan secili nga një ekosistem.

4 tetor, Dita Botërore e Mbrojtjes së Kafshëve

Në kuadër të kësaj dite, specialistët e AdZM Lezhë së bashku me nxënësit e shkollës 9- vjeçare “Nike Tome Prela” në Gorre u njohën me karakteristikat e Rrëqebullit të Ballkanit, si një prej kafshëve më të rrezikuara në PN Munellë, duke ngjyrosur secili prej tyre nga një fletëpune të tillë. Të ndarë në grupe, ata renditën disa prej rregullave të sjelljeve të njeriut në natyrë. Përmes këtij ushtrimi fëmijët mund të kuptojnë rëndësinë e sjelljes së mirë në ekosisteme natyrore, duke shmangur shqetësimin e kafshëve dhe mbrojtur mjedisin në të cilin ata jetojnë.



25 tetor, Dita e Qëndrueshmërisë

Në vijim të programit të edukimit mjedisor, specialistët e AdZM Lezhë punojnë për realizimin e orëve mjedisore. Qëllimi i programit dhe ekspertëve tanë është njohja e nxënësve me zonat e mbrojtura; në të njëjtën kohë informimi dhe sensibilizimi i fëmijëve për mjedisin. Për t'i bërë sa më të këndshme dhe tërheqëse orët mjedisore, nuk mungojnë lojërat e ndryshme në mjediset e klasave dhe mjediset e jashtme, pranë shkollave.

“Botanistët e vegjël”

Zonat e mbrojtura kanë një florë të pasur. Ajo mund të shpërfaqet për grupmosha të ndryshme, mjafton dëshira dhe përcjellja e informacionit të përshtatshëm. Për të njohur nxënësit me florën e pasur, specialistët e AdZM Lezhë morën disa gjethë nga bimët dhe drurët e RNM “Kune - Vain - Patok - Fushe Kuqe – Ishëm” dhe së bashku me fëmijët e kopshtit pranë shkollës 9-vjeçare “Adriatik” krijuan disa fletë herbariumi. Botanistët treguan përkushtim dhe dëshirë përgjatë realizimit të herbariumit të tyre.

“Edukimi mjedisor” nga AdZM Dibër

fatkeqësi natyrore parandalimi i dëmit herbarium komponent mjedisor cilësi e jetës



2 tetor, Dita Botërore e Habitave

Në kuadër të Ditës Botërore të Habitave, specialistët e AdZM Dibër realizuan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës “Irfan Hajrullai”. Ata u njohën me herbariumin, rëndësinë e tij dhe vlerat që ai mbart dhe mënyrat se si të bëjnë një herbarium në kushte shtëpie, me bimë të llojeve të ndryshme.

4 tetor, Dita Botërore e Kafshëve

AdZM Dibër, më 4 tetor, realizoi një orë mjedisore me aktivitete interaktive, për fëmijët parashkollorë të shkollës 9-vjeçare “Myslim Shehu” Kamen. Fëmijët u njohën me llojet e kafshëve si dhe mësuam më shumë rreth jetesës së tyre në vende të ndryshme.

13 tetor, Dita Ndërkombëtare për Uljen e Fatkeqësive Natyrore

AdZM Dibër në kuadër të kësaj dite realizoi një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Katund i Ri” Luzni. Ishte kënaqësi të dëgjoje njohuritë e shprehura nga nxënësit për: tërmetet, vullkanet, zjarret, thatësi, përmbytjet, rrëshqitjet e tokës, mbrojtjen e florës dhe faunës, ujërave, tokës së bukës etj. Në fund secili nga nxënësit shprehu ide mbi mundësitë e parandalimit të dëmit në mjedis, për të ulur sadopak ndikimin kundrejt fatkeqësive natyrore.

15 tetor 2023, Dita e Ecjes në Natyrë

Pranë Parkut Natyror “Liqeni i Ulzës”, specialistët e AdZM Dibër realizuan një orë mjedisore, me nxënësit të shkollës 9-vjeçare “Papa Gjon Pali II” në kuadër të datës 15 tetor. Fokusi i orës mësimore ishte mbi rëndësinë që ka mjedisi me të gjithë komponentët përbërës të tij dhe rolin që luajnë zonat e mbrojtura në përmirësimin e cilësisë së jetesës së banorëve që jetojnë brenda këtyre zonave dhe përreth tyre. Në fund të orës së edukimit mjedisor, së bashku me nxënësit realizuam ecjen përgjatë një shtegu të shkurtër në park, duke ju treguar atyre bukuritë natyrore dhe vlerat që ai ka.

ndryshimet klimatike habitate tokësore dhe ujore mirëqenia e kafshëve piramida ushqimore



2 tetor, Dita Botërore e Habitave

Habitatet janë territore tokësore ose ujore, ku gjallesat rriten, ushqehen, jetojnë dhe shumohen. Ndaj, kërkohet kujdesi ynë, duke mos i dëmtuar dhe shkatërruar ato, përmes aktiviteteve njerëzore. Në kuadër të Ditës Botërore të Habitave, specialistët e AdZM Durrës zhvilluan një orë mjedisore, në shkollën 9-vjeçare “Selman Ali Xaka” në Nojë. Përmes fotove dhe informacionit të hollësishëm, nxënësit u njohën me konceptin e habitatit dhe me disa nga llojet e tij.

4 tetor, Dita Botërore për Mbrojtjen e Kafshëve

Specialistët të AdZM Durrës zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Myrteza Pengili” në Krujë, nën moton “Planeti ynë ka vend për të gjithë” Ora mjedisore kishte si qëllim rritjen e ndërgjegjësimit për përmirësimin e standardeve të mirëqenies së kafshëve. Nxënësit, me anë të fletëve ilustruese u njohën me disa nga llojet kryesore të faunës së Parkut Natyror “Qafështamë”.

16 tetor, Dita Botërore e Ushqimit

Përgjatë kësaj dite, specialistët të AdZM Durrës zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Zenel Qazim Tepshi” në Krujë. Nxënësit me dëshirë dhe fantazi përgatitën piramidën ushqimore. Po ashtu ata treguan se cilat janë ushqimet më të rëndësishme për organizmin, për të jetuar në mënyrë të shëndetshme dhe sa më të gjatë.

24 tetor, Dita Ndërkombëtare e Veprimeve për Klimën

Specialistët të AdZM Durrës zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Mustafa Myrteza Kaçaçi” në Krujë. Aktiviteti pati si qëllim demonstrimin e faktorëve kryesore që shkaktojnë ndryshimet klimatike. Së bashku me nxënësit shkëmbyem informacion dhe ide, mbi nismat dhe veprimet konkrete që mund të ndërmarë komunitetin i nxënësve dhe ai i prindërve, në zbutjen e ndryshimeve klimatike.



ndryshimet klimatike efekti serë

shteg për këmbësorët
mjete monitorimi

4 tetor, Dita Botërore e Kafshëve

Në kuadër të kësaj dite zhvilluam një orë mjedisore me nxënësit e klasës së 5-të të shkollës 9-vjeçare, “Ymer Lala” në Surrrel. Nxënësit u njohën me faunën e egër të Parkut Kombëtar “Mali i Dajtit”, mënyrat e ruajtjes, monitorimit dhe vëzhgimit të saj. Nxënësit mundën të shuanin kërshërinë e tyre, duke vëzhguar nga afër mjetet e monitorimit të kafshëve, banorëve të përhershëm të pyllit.

15 tetor, Dita Ndërkombëtare e Ecjes në Natyrë

Stafi i AdZM Tiranë këtë datë e kujtoi bashkë me një grup të apasionuarish të natyrës. Së bashku përshkuam shtegun këmbësor malor Fusha e Dajtit-Gryka e Tujanit. Pjesëmarrësit shijuan pejzazhet e PKMD dhe fragmente të MN “Karstit të Malit me Gropa”, “Shpella e Mirë”, Shkalla e Tujanit”. Kjo ditë shërbeu për ndarjen e informacionit rreth vlerave të ZM-ve dhe rritjen e ndërgjegjësimit për ruajtjen e tyre ndër breza.



24 tetor, Dita Ndërkombëtare e Veprimeve për Klimën

Stafi i AdZM Tiranë zhvilloi një orë mjedisore me nxënësit e klasës së 5-të të shkollës 9-vjeçare, Surrrel “Ymer Lala”. Ata njohën shkaqet e ndryshimeve klimatike, pasojat, efektin sere dhe masat e nevojshme për zvogëlimin e tyre. Nxënësit shkëmbyen me njëri-tjetrin mesazhe ndërgjegjëse.

“Edukimi mjedisor” nga AdZM Elbasan

monumente natyre prodhuesit e ushqimit ekosisteme natyrore fatkeqësi natyrore konsumatorët e ushqimit ushqim i shëndetshëm

2 tetor, Dita Botërore e Habitatit

Edukimi mjedisor, për specialistët e AdZM Elbasan, për muajin tetor filloi me orën mjedisore “Dita Botërore e Habitatit”. Me nxënësit e Shkollës së Mesme të Bashkuar “Isak Alla” Zgosht, pjesë e “Parkut Kombëtar Shebenik”, zhvilluam një orë informuese e argëtuese. Informacioni i përcjellë tek nxënësit ishte mbi ekosistemet natyrore, vegjetacionin, vlerat dhe pasuritë e zones në florë dhe faunë. Në fund të orës sonë, ata shprehën idetë dhe konceptet e tyre mbi habitatet nëpërmjet vizatimeve.

4 tetor 2023, Dita Botërore për Mbrojtjen e Kafshëve

Në kuadër të kësaj dite, AdZM Elbasan realizoi një orë mjedisore informuese dhe argëtuese me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Kuturman”, në afërsi të Rezervatit Natyror të Menaxhuar “Kuturman”. Nxënësit u njohën me rëndësinë e kësaj dite dhe faunën e egër të zonës së mbrojtur. Më pas, të ndarë në grupe vizatuan kafshë të ndryshme, të cilat i vendosën në këndin e krijuar enkas për to. Mesazhi që nxënësit përçuan përmes kësaj dite ishte: Çdo krijesë e gjallë në Tokë ka të drejtë të trajtohet me dashuri dhe përkujdesje.

10 tetor, promovojmë vlerat natyrore

Specialistët e AdZM Elbasan realizuan një orë mjedisore me nxënësit e Shkollës 9- vjeçare “18 Gushti Shëmrizë” në afërsi të Parkut Kombëtar “Mali i Tomorrit”. Për nxënësit paraqitëm vlerat natyrore dhe mjedisore të parkut, florën dhe faunën. Nxënësit u njohën edhe me monumentet e natyrës, të cilat ndodhen në territorin e Bashkisë Gramsh dhe administrohen e menaxhohen nga Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura Elbasan. Orët mjedisore kanë si qëllim njohjen, promovimin e vlerave dhe bukurive natyrore, mbi të gjitha, dashurinë për natyrën tek brezat e rinjë, të cilët e shprehin gjithmonë në takimet tona.

13 tetor, Dita Ndërkombëtare për Uljen e Fatkeqësive Natyrore

Në kuadër të kësaj dite specialistët realizuan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Ramazan Bala” në Xibrakë, pjesë e Rezevatit Natyror të Menaxhuar “Qafë- Bush”. Gjatë kësaj ore nxënësit u njohën me shkaqet dhe pasojat që shkaktojnë fatkeqësitë natyrore, siç janë: erozioni, përmbytjet, zjarret në pyje, mënyrat sesi secili prej nesh mund të ndihmojë në zbutjen e tyre, fenomene të cilat ndikojnë në prishjen e habitatit të kafshëve, dëmtimin e florës, deri në zhdukjen e tyre.

15 tetor, Dita Botërore e Ushqimit

Specialistët e AdZM Elbasan, në kuadër të kësaj dite realizuan një orë mjedisore me nxënësit e Shkollës 9-vjeçare “Hajdar Kullafi” Letëm, pjesë e Parkut Kombëtar “Shebenik”. Gjatë kësaj ore nxënësit u njohën me rëndësinë e kësaj dite, përsa i përket ushqimit dhe të ushqyerit shëndetshëm. Ata ndërtuan edhe zinxhirin ushqimor, duke krijuar idenë dhe rëndësinë e raportit midis prodhuesit dhe konsumatorit sipas rendit.



vrojtim i flamingove habitate të qëndrueshme rrugë shtegtimi piramida e zinxhirit ushqimor kulturë perimesh

02 tetor, Dita Botërore e Habitave

Stafi i AdZM-së së bashku me Shoqatën Ornitologjike të Shqipërisë (AOS) zhvilluan aktivitetin Eurobirdwatch 2023, përgjatë të cilit, me vizitorë vendas dhe të huaj vëzhguam shpendët. Qëllimi i kësaj dite është që t'i kujtojë mbarë botës përgjegjësitë e saj, të cilat ndikojnë për të ardhmen e habitateve të qëndrueshme mjedisore.

04 tetor, Dita Botërore e Mbrojtjes së Kafshëve

Në kuadër të kësaj dite, AdZM Fier ndërmori nismën të ushqej dhe të kujdeset për disa kafshë, të cilat janë të braktisura dhe strehohen në Parkun Kombëtar Divjakë-Karavasta. Përmes nismës rikujtuam publikun e gjerë për rëndësinë që ka mbrojtja e kafshëve. Në PK Kombëtar Divjakë-Karavasta strehohen disa kafshë të braktisura. Punonjësit e parkut kujdesen për këto kafshë prej disa vitesh.

11 tetor, fëmijët vizitojnë flamingot

Fëmijët e Kopshtit “Iliria” Lushnjë vizituan Parkun Kombëtar Divjakë-Karavasta. Nëpërmjet materialeve edukuese ata u njohën me vlerat natyrore dhe bukuritë e Parkut. Në përfundim të vizitës së tyre, fëmijët vrotuan flamingot në Godullën e Vogël.

14 tetor, Dita Ndërkombëtare e Shpendëve Shtegtarë

Në bashkëpunim me Shoqatën Ornitologjike të Shqipërisë zhvilluam një aktivitet me fëmijët e Shkollës “Gërmenj”. Nxënësit u njohën me shpendët e ndryshëm që gjenden në park, rrugën e tyre të shtegëtimit si dhe me rreziqet që përballen përgjatë këtij procesi. Më pas, të gjithë së bashku realizuam një aktivitet ndërgjegjësues, duke pastruar Kanalin e Vaut.

16 tetor, Dita Botërore e Ushqimit

Në kuadër të kësaj dite, me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Hysen Malko” Kryekuq, Divjakë zhvilluam një vizitë në tokat e mbjella nga fermerët. Fëmijët u njohën me kulturat e ndryshme të perimeve, kohën në të cilën ato mbillen dhe kohën që dalin në treg për t'u shitur. Gjatë orës mjedisore nxënësit përgatitën edhe piramidën e zinxhirit ushqimor.

23 tetor, studentë dhe profesorë francezë vizitojnë Lagunën e Karavastës

Patëm kënaqësinë të mirëprisnim dhe shoqëronim, studentë dhe profesorë të Shkollës Pyjore “BTSa Gestion Forestière-ISETA” Francë. Të gjithë së bashku zhvilluam një vizitë në brendësi të pyllit me pisha të Divjakës. Vizitorët u njohën me larmishmërinë e biodiversiteti që ka parku, duke vizituar edhe pishën më të vjetër të rrëzuar para një viti. Më pas vëzhguam peizazhin e mrekullueshëm dhe faunën në Lagunën e Karavastës.

24 tetor, Dita Ndërkombëtare e Veprimeve për Klimën

Së bashku me nxënësit e shkollës “GDQ International Christian School”, AdZM Fier zhvilloi një aktivitet mjedisor. Përgjatë tij nxënësit zhvilluan praktikën mësimore, duke marrë informacion të përgjithshëm në Qendrën e Vizitorëve dhe më pas vazhduan në terren, për t'u njohur nga afër me vlerat natyrore të Parkut Kombëtar Divjakë-Karavasta.



“Edukimi mjedisor” nga AdZM Korçë

ushqime të shëndetshme specie të rrezikuara mësojmë përmes argëtimit

4 tetor, “Dita Botërore e Kafshëve”

Në kuadër të kësaj dite zhvilluam një orë mjedisore në shkollën “Raif Kolami” të fshatit Tren. Nxënësit u njohën me disa nga kafshët që jetojnë pranë zonave tona të mbrojtura dhe speciet me të rrezikuara. Po ashtu, secili prej nxënësve pikturoi kafshën e tij të preferuar.

16 tetor, Dita Botërore e Ushqimit

Pranë kopshtit “Toy Story” në kuadër të ditës botërore të ushqimit, fëmijët përmes fantazisë pikturuan frutat, perimet dhe ushqime të tjera të shëndetshme. Gjithashtu përmes copave të vogla të ushqimit, fëmijët përgatitën hartën fizike të Shqipërisë. Nxënës të të gjitha moshave përmes krijimeve të tilla, jo vetëm mësojnë përmes argëtimit, por njëkohësisht shpërfaqin gjithë fantazinë dhe dëshirat e tyre.



24 tetor, Dita Ndërkombëtare e Veprimeve për Klimën

Aktiviteti u zhvillua në shkollën “Sotir Gura” në qytetin e Korçës. Nxënësit mësuuan për veprimet konkrete që ata mund të ndërmarrin kundrejt ndryshimeve klimatike që po ndodhin në vend. Përmes fletëve të punës, ata paraqitën motin në qytetin e tyre përgjatë një jave, duke evidentuar fenomenet që ndodhin, si p.sh., ndryshimi i temperaturës. Po në këtë ditë zhvilluam një aktivitet në shkollën “Papa Kristo Negovani” në qytetin e Ersekës, me nxënës të klasave të 7-ta. Nisma në kuadër të kësaj dite vazhdoi të zhvillohet edhe me nxënësit e shkollës “Sami Zgjani” në fshatin Guras.

26 tetor, “Gara e memories”

Me nxënës të shkollës “Rezidenca e Goricareve” në fshatin Goricë organizuam një orë mjedisore për pelikanin kaçurrel dhe atë rozë. Pas ndarjes së informacionit për këto dy specie nga eksperti ynë, nxënësit organizuan garën e memories, duke përmendur informacionin e dhënë dhe atë të mëparshëm që ata kishin mbi këto dy specie.

27 tetor, në shkollën “Myredin Bashalli” në Lin

U zhvillua një orë mjedisore në shkollën 9-vjeçare “Myredin Bashalli” në Lin, ku nxënësit u njohën me vlerat specifike Natyrore dhe Kulturore që gëzon zona dhe Peizazhi i Mbrojtur “Liqeni i Pogradecit” në tërësi.

30 tetor, në shkollën “Rezidenca e Goricarëve”

U zhvillua një aktivitet në bashkëpunim me shoqatën PPNEA dhe nxënësit e shkollës “Rezidenca e Goricarëve” në Goricë, për vrojtimin e shpendëve të liqenit, dhe mënyrën sesi mund të evidentohen specie të ndryshme, përmes karakteristikave që ata kanë.

30 tetor, në Universitetin e Korçës

Pranë mjedisve të Universitetit të Korçës, me pjesëmarrjen e studentëve të programit të studimit “Turizëm” dhe “Gjeografi”, me shoqatën ACEG dhe Sportin Kayak Albania, në kuadër të nismës “Parqe të shëndetshëm”, “njerëz të shëndetshëm” organizuam një orë të hapur seminari.

menaxhim i situatës fatkeqësi natyrore ndryshime klimatike veprime për klimën



4 tetor, Dita Botërore për mbrojtjen e “Kafshëve”

Është zhvilluar një orë edukimi mjedisor nga specialistët e AdZM Berat, në shkollën jopublike “Drita e Dijes”, gjithmonë mikpritës të dijes. Për nxënësit shfaqëm videove dhe foto, për faunën e egër të parkut tonë kombëtar “Mali i Tomorrow”, duke theksuar qëllimin që kemi për mbrojtjen e tij.

13 tetor, Dita Ndërkombëtare për uljen e Fatkeqësive Natyrore

U zhvillua një orë edukimi mjedisor, përmes prezantimeve, videove dhe fotove rreth fatkeqësive natyrore. Bashkë me nxënësit e klasës së 4-ët, të shkollës 9-vjeçare “1 Maj” improvizuam një rast konkret, në rast tërmeti në mjediset e shkollës, duke treguar dhe shpjeguar sjelljet e reagimet për menaxhimin e situatës.

24 tetor, Dita Ndërkombëtare e Veprimeve për Klimën

Bashkarisht me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “1 Maj” diskutuam mbi ndryshimet klimatike, shkaktarët dhe pasojat e këtyre ndryshimeve. Më pas vetë nxënësit na treguan oborrin e shkollës, të gjelbëruar dhe me lule. Përmes kësaj panorame nxënësit përcollën mesazhin: “Secili nga ne mund të kontribuojë, duke vepruar konkretisht ndaj ndryshimeve të klimës”.



teori bashkëbiseduese jeta e egër kamerat e kurthit qëndrueshmëria e habitateve praktikë eksperimentale

2 Tetor 2023, Dita Botërore e Habitave

Qëllimi i kësaj dite është t'i kujtojë botës përgjegjësitë e saj për një të ardhme të qëndrueshme të habitateve mjedisore, duke reflektuar dhe vepruar në mbrojtjen e tyre. Për këtë ditë, AdZM Gjirokastrë organizoi në shkollën 9-vjeçare “Nonda Bulka” në Përmet një orë mjedisore. Nxënësit u njohën me habitatet kryesore të Parkut Kombëtar “Bredhi i Hotovës Dangëlli”, si territor me biodiversitet të lartë dhe të qetë për jetën e egër.

4 Tetor 2023, Dita Botërore e Kafshëve

Në bashkëpunim me ZVA Gjirokastrë, AdZM zhvilloi në shkollën 9-vjeçare jopublike “Xhuzepe Grass” në Gjirokastrë, një orë mjedisore me temë “Zonat e Mbrojtura - Strehë e Jetës së Egër”. Nxënësit u njohën dhe vizatuan llojet kryesore të faunës, pjesë e ZM-ve, ndërsa specialistët ndan informacione mbi rolin dhe rëndësinë e jetës së egër në ekosistemet tona dhe mënyrat sesi ne mund të kujdesemi për to.

9 Tetor 2023, fëmijët mësojnë përmes lojës

AdZM Gjirokastrë në bashkëpunim me Eco Albania zhvilluan një orë mjedisore me shkollën “Kamber Bënja”, Këlcyrë. Edukimi vijoi me lojëra interaktive dhe edukative mbi çështjet mjedisore.





11 Tetor 2023, përmes videove fëmijët njohin jetën e egër të ZM-ve

Specialistët e AdZM Gjirokastrë kanë zhvilluar një orë mjedisore me fëmijët parashkollorë të shkollës "Urani Rumbo". Nëpërmjet videove të përfutuara nga kamerat e kurthit, fëmijët u njohën me kafshët që jetojnë në zonat e mbrojtura. Së bashku me ta zhvilluam disa lojëra, për t'i njohur më shumë me karakteristikat dhe mënyrën e jetesës së kafshëve të egra.

17 Tetor 2023, "Java e vullnetarizmit në Vjosë"

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe AKZM organizuan "Javën e Vullnetarizmit në Vjosë". Këtij aktiviteti iu bashkua edhe AdZM Gjirokastrë. Në mbështetje të nismës, përgjatë ditës së parë u zhvillua takimi me të rinjtë vullnetarë të Patagonias. Përmes bashkëbisedimit, të rinjtë mundën të diskutonin edhe me grupin, i cili po punon për planin e menaxhimit të parkut.

18 Tetor 2023, në shkollën "Xhuzepe Grass"

AdZM Gjirokastrë në bashkëpunim me Eco Albania zhvilluan një orë mjedisore me shkollën jopublike "Xhuzepe Grass". Përgjatë kësaj ore ndërlidhëm teorinë, bashkëbisedimin dhe praktikën eksperimentale, në funksion të rëndësisë së mbrojtjes së mjedisit. Ora mjedisore vijoi më tej me lojëra interaktive, mbi ndotjen që shkakton njeriu në përditshmërinë e tij.

20 Tetor 2023, në shkollën 9-vjeçare "Piskovë", Përmet

AdZM Gjirokastrë në bashkëpunim me Eco Albania zhvilluan një orë mjedisore me shkollën 9-vjeçare "Piskovë", Përmet. Edukimi vijoi me lojëra interaktive dhe edukative mbi çështjet mjedisore.





